

KOMENTET DHE SUGJERIMET E AMPEK-ut

Rregullorja për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio - vizuale dhe shërbimeve radio mediale përmes operatorëve të rrjetit.

AMPEK-u e vlerëson si shumë pozitive nismën për ndryshimin e rregullores për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio - vizuale dhe shërbimeve radio mediale përmes operatorëve të rrjetit.

Megjithatë kjo rregullore në formën e propozuar në masë të madhe dështon t'i adresojë problemet kryesore të aspektit të rregullimit të shpërndarjes së shërbimeve mediale audio - vizuale dhe shërbimeve radio mediale përmes operatorëve të rrjetit dhe njëkohësisht të krijojë përshtypjen se është ende e papërfunduar.

Për më tepër ky draft i propozuar ka madje më shumë defekte edhe sesa rregullorja e vjetër e KPM-së (ende në fuqi, CIMC- 2007/04), e cila siç dihet, asnjëherë nuk ka arritur të zbatohet plotësisht.

Për fat të keq, aspektet kryesore të rregullimit të operatorëve të rrjetit, të përcaktuara sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, nuk janë fare të përfshira në këtë draft.

Andaj, rekomandojmë që kjo rregullore në vijim të përfshijë këto çështje:

1. Në radhë të parë të përfshijë ndarjen në tri lloje të shërbimeve kabllore brenda një platforme.

Pakoja bazike (basic service)

Pakoja e zgjeruar programore (Cable programming service)

Pakoja e televizioneve me pagesë (Per-channel or per-program, gjithashtu e njohur si pay-per-view service)

Pakoja bazike (basic service) duhet të definohet si niveli më bazik dhe më i lirë i shërbimit të rrjetit, të cilin konsumatori mund ta paguajë. Aty duhet të përfshihen: transmetuesi publik si dhe të gjitha televizionet tokësore (free to air) e që kjo rregullore duhet t'i përkufizojë si kanale me bartje të obligueshme (must carry). Gjithashtu në pakon bazë duhet të përfshihen edhe kanale tjera vendore në shërbim të publikut (ofruesit e shërbimeve programore), e që janë të licencuara nga KPM.

KPM-ja do të duhej ta rregullonte pakon bazike edhe në aspektin e vendosjes logjike/lokale të kanaleve numerike (LCN) si dhe të siguronte që për këtë pako të paguhet vlera minimale, duke përcaktuar limitin mbi të cilin nuk mund të shkohej e që do të merrte parasysh edhe mundësitë financiare të shfrytëzuesve por edhe fitimin e arsyeshëm të operatorëve të rrjetit.

Këtu do të duhej ngritur çështjen e pranuesve (receiver) të sinjalit, të cilat meqë blihen nga konsumatori, ky i fundit do të duhej të kishte qasje në ofertë më të gjerë pajisjesh.

Pakoja e zgjeruar (Cable programming service) duhet të përfshijë të gjitha kanalet tjera të cilat nuk janë të përfshira në pakon bazike dhe të cilat gjithashtu nuk mund të ofrohen si televizione me pagesë. Këtu hyjnë televizionet nga rajoni dhe televizione nga Evropa dhe kontinentet e tjera.

Pakoja e televizioneve me pagesë (pay per view) ku përfshihen shërbimet /kanalet e vetme apo programet individuale për të cilat operatori i rrjetit vendosë çmime të veçanta.

2. Bartja e obligueshme (must carry)

Është standard i pranuar evropian dhe ndërkombëtar që kur televizionet vendore (tokësore) zgjedhin statusin e bartjes së obligueshme, atëherë është obligim i operatorit të rrjetit t'i bart ato pa kompensim. Gjithashtu është standard që operatorët e rrjetit të 'rezervojnë 1/3 e kapacitetit të tyre programor/të kanaleve për mediat që përbëjnë bartje të obligueshme.

KPM në draftin e propozuar Neni 8 në mënyrë shumë të paqartë dhe të padefinuar saktësisht, ka përshkruar obligimet e bartjes së detyrueshme, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme e duke i ngarkuar TV/radiot e obligueshme (must carry) edhe me kosto të shërbimeve teknike tutje në nenin 12 (Neni 12.3).

Në mënyrë decisive kërkojmë që, rregullat e bartjes së obligueshme të definohen ashtu siç kanë qenë në rregulloren e vjetër për distribuim kabllor ***(CIMC- 2007/04) konkretisht Neni 12 i kësaj rregulloreje: Kërkesat për transmetim të obligueshëm***, andaj ky nen të duhet bartet në rregulloren e re.

Neni i propozuar do të pësojë modifikime edhe në pikën 12.3.3 pika b) që do të parashohë me sa vijon:

- 1) “Nëse televizionet nacionale dhe lokale tokësore të licencuara nga KPM-ja, nuk arrin të merren vesh me operatorët e rrjetit për kushtet financiare të bartjes në platforma, do të zgjedhin që të bëhen televizione me bartje të obligueshme dhe që janë ofertë e obligueshme për konsumatorin, pa kompensim.”

Kjo nënkupton se kur të kalojë afati i parapagimit, konsumatori do të ketë qasje në kanalet nacionale me status “të bartjes dhe ofertës së obligueshme” në të gjithë territorin e shtetit; kurse te televizionet lokale, në rajonin për të cilin janë licencuar këta të fundit.

KPM sigurisht se është në dijeni që në të kaluarën edhe duke ekzistuar një nen i tillë në rregullore, ka dështuar në implementim, andaj “liberalizimi” i skajshëm i këtij neni, siç është propozuar (duke mos përfshirë as periudhë negociuese) do të krijojë probleme shumë të mëdha për televizionet/radiot e licencuara nga KPM-ja.

Gjithashtu te Neni 4 i rregullores së propozuar duhet shtuar edhe një formulim që sqaron se operatorët e rrjetit nuk e ruajnë asnjë drejtë diskrecionale për të ushtruar imponuar ndonjë pengesë teknike që do ta censuronte lirinë e shprehjes. Duhet të jetë obligim i KPM-së që të sigurojë mosabuzimin me pozitën dominante të operatorit apo operatorëve të rrjetit në treg, që do të çonin drejt monopolizimit të tij.

3. Restriktionet për pronësi vertikale

Për të evituar favorizimin e kanaleve të lidhura/asocuara (ose në pronësi të përbashkët) me operatorin e rrjetit në raport me kanalet e tjera, KPM-ja duhet të parashohë një nen të veçantë ku duhet të përcaktojë një limit kanalesh të cilat janë të lidhura me operatorin e rrjetit e që do të zënë vend në platformën e kanaleve.

Në këtë kontekst, propozojmë që të vendoset një limit prej 40% të kapaciteti të platformës për kanalet e asocuara me operatorin. Për qëllim të definimit të “pronësisë së përbashkët” çdo interes që kalon 5% duhet të konsiderohet si i tillë.

4. Të drejtat e autorit dhe mbrojtja e të miturve

Neni 7 i rregullores së propozuar, duhet të parashohë dhe të definojë në mënyrë më decisive mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të miturve. Mënyra se si është propozuar aktualisht (Nenet 7.4 dhe 7.5) duhet qartësuar tutje, kurse këto aspekte duhet të rregullohen edhe me ndarjen e platformave në pako të ndryshme të shërbimeve (ashtu siç është propozuar më lart).

Pra, operatori rrjetit duhet të sigurojë që në pakon bazike të futen televizionet tokësore apo ofruesit e përmbajtjeve të licencuar nga KPM që transmetojnë programe me të drejta për FreeTV/Basic cable, duke mos cenuar të drejtat ekskluzive/jo ekskluzive të përmbajtjeve për territorin e Kosovës, në pajtim me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e përafërta. Në këtë pako duhet të ndalohet ofrimi i përmbajtjeve apo ofruesve të shërbimeve programore me të drejta për Pay TV.

5. Të drejtat e shfrytëzuesit (parapaguesit) propozojmë të përfshihen si vijojnë:

Operatori i rrjetit duhet të sigurojë që shfrytëzuesit /parapaguesit të kenë mundësinë të shfrytëzojnë pranues të teknologjisë neutrale, duke rezervuar të drejtën e operatorit që të aplikojë qasjen e kufizuar për përmbajtjet audio vizuale të ofertës së vet, në pajtim me nenet e kësaj rregulloreje.

Operatori i rrjetit duhet të sigurojë që shfrytëzuesi/parapaguesi të ketë mundësinë që lirshëm të bëjë ri-programimin e renditjes numerike të programeve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe mbylljen prindërore në kuadër të pakos programore të kontraktuar apo të parapaguar.

Për të përmbushur të drejtën e konsumatorit për informim të lirë, operatori i rrjetit obligohet që t'i mundësojë shfrytëzuesit shikimin e përmbajtjeve audio vizuale me status të bartjes së obligueshme (must-carry) deri në përmbyllje apo prishje eventuale të kontratës për shfrytëzim të shërbimeve nga cilado palë.

6. Në aspektin teknik duhet shtuar këto çështje:

Operatori i rrjetit është i obliguar që të sigurojë se niveli i sinjalit, ndryshimi i niveleve të sinjaleve nëpër kanale, raportet sinjal-zhurme, sinjal-interference dhe sinjal-intermodulim si dhe niveli i izolimit ndërmjet dy shfrytëzuesve të fundmë do të jenë në pajtim me standardin CENELEC EN 50083-7 dhe EN 50083-7/A1.

Kualiteti i sinjalit të përmbajtjeve audio vizuale duhet të arrijë të paktën shkallën 4 sipas metodologjisë për vlerësim subjektiv të kualitetit të sinjalit televiziv të përshkuara në rekomandimin ITU-R BT 500-13 (2012/01).

Përfundimisht , një nen shumë kontrovers është Neni 17.3, i cili i obligon ofruesit e përmbajtjeve programore që përmes operatorit të rrjetit të aplikojnë për licencë. Pse duhet OSHP-të përmes operatorëve të rrjetit të licencohen?!

Autoriteti i vetëm që licencon mediat elektronike në Kosovë është KPM-ja. Me këtë propozim, KPM-ja bart një pjesë të kompetencave të saj kushtetuese tek operatorët e rrjetit dhe krijon mekanizëm dy nivelesh licencimi, në kundërshtim me ligjin e KPM-së dhe Kushtetutën e Kosovës.

Propozojmë që Neni 17.3 të fshihet në tërësi.